

**VENDIM**  
**Nr. 20, datë 19.4.2019**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR  
MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË LARGIMIT TË UJËRAVE TË  
NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.4.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Miratimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe”,

konstatoi se:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) me vendimin nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Malësi e Madhe”, për kategorinë e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

Me vendimin nr. 78, datë 26.11.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Malësi e Madhe”, i ndryshuar, shoqëria UK Malësi e Madhe u licencua nga KKRR-ja për ushtrimin e aktivitetit të largimit të ujërave të ndotura për Njësinë Administrative Koplik.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe, me shkresën nr. 75 prot. datë 18.2.2019, ka aplikuar pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura.

Me anë të shkresës nr. 89 prot. datë 28.2.2019, “Dërgim dokumentacioni”, UK Malësi e Madhe plotësoi dosjen e aplikimit në përputhje me vendimin nr. 40.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Malësi e Madhe është i bazuar ligjërish dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe dhe Bashkinë Malësi e Madhe për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**